



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 31.03.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1502_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenit 26, paragrafit 1, nënparagrafin 1.2, Nenit 28, paragrafit 2, nënparagrafit 2.10, Nenit 30 dhe Nenit 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 33 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10, Nenin 4, Nenin 6, Nenin 7, Nenin 8 dhe Nenin 15 të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Aplikacionin me dokumentet e bashkëngjitura, të datës 13.04.2021 (online) dhe 05.08.2021 (përmes administratës së Rregullatorit) për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike, të bërë nga ndërmarrja **MCM COMMODITIES Sh.P.K.**, adresa: Rr. Nëna Terezë, Nr.1, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 31 mars 2022 nxori këtë:

VENDIM

- I. I LËSHOHET LICENCA** për Furnizim me Energji Elektrike ndërmarrjes **MCM COMMODITIES Sh.P.K.**, me numër Licence **ZRRE/Li_71/21**, për periudhën kohore prej **31.03.2022** deri me **30.03.2027**.
- II. Obligohet** ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për **MCM COMMODITIES Sh.P.K.**, të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 13.04.2021 (online) dhe 05.08.2021 (përmes administratës së Rregullatorit) ka pranuar nga ndërmarrja **MCM COMMODITIES Sh.P.K.**, Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të Furnizimit me energji elektrike në Kosovë.
- o Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit dhe kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të furnizimit me energji elektrike në Kosovë dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
- o Sipas Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja **MCM COMMODITIES Sh.P.K.**, me datë 09 shkurt 2022 ka njoftuar përmes gazetës (portaleve online) palët e interesit se ka dorëzuar një aplikacion në Rregullator për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike dhe se aplikacioni është në fazën finale për marrje të licencës.



- o Sipas Nenit 6 të Rregullës së sipërpërmendur, palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditë kalendarike, nga data kur njoftimi është publikuar në gazetë. Rregullatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim të bërë nga palët e interesit, për këtë aplikacion.
- o Rregullatori në përputhje me nenin 7 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar.
- o Licenca e lëshuar sipas këtij Vendimi do të vazhdojë të jetë e vlefshme për periudhën sipas pikës I të dispozitivit të këtij Vendimi, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës në pajtim me Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- o Rregullatori pas vlerësimit të aplikacionit dhe dëshmive të tjera të bashkangjitura aplikacionit të ndërmarrjes MCM COMMODITIES Sh.P.K. dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Ndërmarrjes MCM COMMODITIES Sh.P.K, dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji


Bordi i Rregullatorit:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar